



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2021, merr këtë

### **V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhemail Bajramit, Gani Bajramit, Fahredin Emerllahut, Ramadan Bajramit, Hajdin Bajramit, Hida Bajramit dhe Hajrullah Etemit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale, nr. 01411-0, me sip. 588m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-01411-0, Zona kadastrale, Matiçan, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër", i miratuar me vendimin nr. 01. nr. 035-186861, dt.02.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale nr. 01674-2, sip. 588 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale, Matiçan, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-01674-2, në pronësi të Xhemail Bajramit, Gani Bajramit, Fahredin Emerllahut, Ramadan Bajramit, Hajdin Bajramit, Hida Bajramit dhe Hajrullah Etemit, me destinim - rrugë, planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01. nr. 035-186861, dt.02.10.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01. nr. 035-186861, dt.02.10.2013, në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

### Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-151181/19, dt.17.12.2020, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës kadastrale nr. 01411-0, sip. 588m<sup>2</sup>, ZK, Matiçan, në pronësi të Komunës së Prishtinës, e cila gjendet në kuadër të bllokut urban "A 19" të Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" në Prishtinë dhe pjesën e parcelës nr. 01674-2, me sip. 588m<sup>2</sup>, ZK, Matiçan, në pronësi të Xhemail Bajramit, Gani Bajramit, Fahredin Emerllahut, Ramadan Bajramit, Hajdin Bajramit, Hida Bajramit dhe Hajrullah Etemit, me destinim – rrugë, planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qender" Prishtinë.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qender" në Prishtinë, Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, 05. nr. 350/02-151181/19, dt.17.12.2019. Pjesa e parcelës nr.1411-0, Zona kadastrale, Matiçan, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa pjesa e parcelës nr.1674-2, Zona kadastrale, Matiçan, Prishtinë, shtrihen në infrastrukturë publike - rrugë e planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/01-46026/21, më 11.03.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

